

KËRKESË
Nr. 340/1, datë 19.1.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës “Xoxi Andoni” dhe hapësirave rreth saj”, shtesat, Fier.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 26,492,996 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

ZËVENDESMINISTRI I
ZHVILLIMIT URBAN
Gjon Radovani

VLERESIME PARAPRAKE PER PASURITE PRONE PRIVATE QE DO TE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE REALIZIMIT TE PROJEKTEVE PER INTERES PUBLIK

Lista emërore e pronareve, pasurite shtese e te cileve do te shpronësohen per realizimin e projektit "Rehabilitimi i rruges Xoxi Andoni dhe hapësirave rreth saj", Fier

Nr.	Emer Mbiemer	Zona Kadastrale	Nr. Pasurise	Sip. Pergj. Truallit (m²)	Sip. Prekur Truallit (m²)	Cmimi per truallin (leke / m²)	Vlera e truallit (leke)	Sip. Totale Nderteses me certificate (m²)	Sip. Prekur Nderteses (m²)	Amortizimi (%)	Vlera e Nderteses me preventiv (leke)	Vlera e Pergjith. (leke)	Gjendja juridike e pasurise
1	Anastas Andon Gjata	8534	3/459	234.40	24.65	12,893	317,812	229.00	17.05	5%	663,110	980,922	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
2	Safet Qenan Troka	8534	3/468	50.00	50.00	12,893	644,650	-	-	-	-	644,650	Inskriptuar 2 herë në favor të Luan Toska dhe Bledar Toska.
3	Agron Sulejman Xhafa + bashkepronare	8534	3/33	1,627.00	1627.00	12,893	20,976,911	-	-	-	-	20,976,911	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
4	Imer Ismahil Osmënaj	8534	3/65 - N2	-	-	-	-	43.60	43.60	20%	699,138	699,138	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
5	Hena Halim Rizaj	8534	3/65 - N5	15.90	15.90	12,893	204,999	31.80	31.80	30%	446,182	651,181	Plotësim dokumentacioni në lidhje me truallin
6	Flamur Myrdar Kondi	8534	3/290	60.00	60.00	12,893	773,580	33.00	33.00	5%	1,766,614	2,540,194	Inskriptuar në favor të Fondit Besa sh.a.
Vlera Totale												26,492,996	

Vlerësimi është bërë duke zbatuar VKM nr.138 datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive prone private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik" dhe VKM nr. 89 datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerësimit të tokës në Republikën e Shqipërisë"

